



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

**RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË
SHTETASVE SHQIPTARË NGA ORGANET E
RENDIT DHE TË DREJTËSISË**

Tiranë, Prill 2004

PËRMBAJTJA

I. Vëzhgimi dhe objektivat e tij

II. Baza ligjore, metodologjia e përdorur dhe vendet ku u shtri vëzhgimi

III. Vëzhgimet në komisariatet e policisë dhe problematika e hasur

- A. Transferimi i sistemit të paraburgimit dhe problemet që lidhen me këtë proces
- B. Të dënuarit me vendim të formës së prerë dhe respektimi i të drejtave të tyre
- C. Mbipopullimi, pasojat e tija dhe kushtet e tjera fizike në komisariatet e policisë
- D. Kushtet sanitare
- E. E drejta për takime me familjarët
- F. E drejta e informimit
- G. E drejta për mbrojtje ligjore dhe njohja me të drejtat e tjera
- H. Probleme të tjera

IV. Rekomandime

Aneks nr. 1 - **Komisariatet e vëzhguara dhe periudha e vëzhgimit (sipas rendit alfabetik)**

Aneks nr. 2 - **Korrespondenca mes KSHH-së dhe institucioneve shtetërore në këtë fushë**

Aneks nr. 3 - **Korrespondentët e KSHH-së në rrethe**

Respektimi i të drejtave të shtetasve shqiptarë nga organet e rendit dhe të drejtësisë

(Bazuar në vëzhgimet e korrespondentëve të KSHH-së në shtatë rrethe të vendit, shkruar nga znj. Edlira Papavangjeli, koordinatore programesh, me konsulencën ligjore të z. Niazi Jaho, këshilltar ligjor i KSHH-së)

I. Vëzhgimi dhe objektivat e tij

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, here pas here, ka vëzhguar respektimin e të drejtave dhe të lirive të shtetasve në fusha të ndryshme. Një ndër këto fusha ka qenë respektimi i të drejtave të shtetasve nga organet e policisë dhe të drejtësisë.

Rrjeti i korrespondentëve të KSHH-së në 7 rrethe të vendit, gjatë periudhës janar-mars 2004 ka ndërmarrë disa misione vëzhgimi në fushën e të drejtave të qytetarëve në kontakt me organet e rendit dhe të drejtësisë. Objektivi kryesor i këtyre vëzhgimeve ka qenë të shihet nga afër si respektohen të drejtat e shtetasve shqiptarë nga organet e rendit dhe nga administrata e komisariateve të policisë dhe e vendeve të paraburgimit. Me gjithë përmirësimet e bëra gjatë këtyre viteve të fundit, janë konstatuar një sërë shkeljesh në këto fusha. Për këtë është ndërhyrë tek organet kompetente për përmirësimin e gjendjes dhe, në disa raste, për sensibilizimin e opinionit të gjerë shoqëror.¹

II. Baza ligjore, metodologjia e përdorur dhe vendet ku u shtri vëzhgimi

Vëzhgimet janë bazuar në kërkesat e legjislacionit shqiptar, si: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi penal, Kodi i procedurës penale, ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, ligji “Për policinë e burgjeve” dhe rregulloret përkatëse.

Vëzhgimi u shtri në shtatë rrethe: Gjirokastrë, Shkodër, Korçë, Elbasan, Kukës, Vlorë dhe Fier dhe u krye nga vetë korrespondentët. Gjatë misionëve të vëzhgimit janë kontaktuar drejtues dhe punonjës të komisariateve, persona të arrestuar ose të dënuar, që ndodheshin në komisariat, familjarët e tyre, avokatë, drejtues të prokurorisë dhe të gjykatës etj.²

¹ Këto raunde vëzhgimesh janë realizuar në kuadër të projektit “Forcimi i rrjetit të korrespondentëve të KSHH-së në disa rrethe të vendit”, financuar nga fondacioni “SOROS”, Tiranë.

² Lutemi shihni në aneksin nr.1 datat e sakta kur janë kryer vëzhgimet dhe personat e kontaktuar nga korrespondentët tanë.

Pas takimeve dhe verifikimeve përkatëse janë hartuar raporte dhe janë informuar organet kompetente. Për probleme të veçanta, KSHH-ja ka reaguar publikisht me deklaratata, në median e shkruar dhe në atë elektronike.

Për të informuar dhe për të sensibilizuar publikun dhe autoritetet për problemet që ekzistojnë në komisariate si dhe për punën dhe veprimtarinë e KSHH-së në përgjithësi e, në veçanti, në fushën e respektimit të të drejtave të qytetarëve në kontakt me policinë, janë realizuar disa emisione në radio dhe në televizione lokale.

KSHH-ja vlerëson frymën e bashkëpunimit të institucioneve shtetërore, si të Ministrisë së Rendit Publik, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat kanë pajisur me leje korrespondentët e KSHH-së si dhe u kanë krijuar lehtësi të tjera për vëzhgimin e komisariateve të policisë dhe dhomave të paraburgimit në rrethet e lartpërmendura. Megjithatë, ka pasur edhe ndonjë rast të veçantë kur korrespondentët e KSHH-s në ndonjë rreth, mbasi janë lejuar të hyjnë në komisariat, nuk janë lejuar të marrin në intervistë të paraburgosurit ose të dënuarit në këto komisariate, pa praninë e personelit të brendshëm në paraburgim. Gjithashtu, vlen të përmendet se, bazuar në kërkesat tona, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka marrë masa konkrete për transferimin e të dënuarve me vendim të formës së prerë në institucionet penitenciare përkatëse³.

III. Vëzhgimet në komisariatet e policisë dhe problematika e hasur

A. Transferimi i sistemit të paraburgimit dhe problemet që lidhen me këtë proces

1. Në nenin 6 të ligjit nr. 8678, datë 14.V.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, thuhet: “Ministria e Drejtësisë drejton sistemin e paraburgimit...”, ndërsa në nenin 16 të po këtij ligji thuhet se “Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve është institucioni në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, ndjek dhe realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit...”. Gjithashtu, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 327, datë 15.III.2003, “Për kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë”, dhomat e paraburgimit kalojnë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Në vijimësi të këtij vendimi, dy ministritë përkatëse, më konkretisht, Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Rendit Publik, nënshkruan një marrëveshje për të bërë kalimin e sistemit të paraburgimit sipas një plani i cili duhet të fillonte në gusht të 2003-së dhe të përfundonte në prill të 2004-s. Ndërkohë, vetëm dhomat e paraburgimit pranë komisariatit të rrethit të Vlorës kanë kaluar nën

³ Shih aneks Nr. 2_për korrespondencën e KSHH-së me autoritetet shtetërore.

varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Nga vëzhgimi i kryer nga korrespondenti i KSHH-së në këtë rreth del në pah se kalimi i dhomave të paraburgimit nën varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ka hasur shumë probleme dhe vështirësi në praktikë. Ndërsa personeli i brendshëm është nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë dhe mbulon sigurinë e brendshme në dhomat e paraburgimit, Policia e Shtetit mbulon sigurinë e jashtme, furnizimin e paraburgimit me mjete higjieno-sanitare, shërbimin mjekësor dhe ushqimin e të paraburgosurve. Kjo lloj ndarjeje përgjegjësish ka sjellë shumë probleme në respektimin e të drejtave dhe trajtimin e të paraburgosurve sipas ligjit në fuqi. Nga kontaktet me drejtuesit e dhomave të paraburgimit në Vlorë u theksua se ky kalim është shumë i cunguar dhe gati formal.

2. Për sa i takon kalimit të dhomave të tjera të paraburgimit nuk mund të justifikohet fakti që, deri më sot, pjesa tjetër e sistemit të paraburgimit ka mbetur ende nën varësinë e Ministrisë së Rendit Publik, ndërkohë që të gjitha parashikimet janë tejkaluar. Edhe një herë, KSHH-ja sugjeron të merren masa konkrete që kjo çështje të zgjidhet në përputhje me ligjin nr. 8678, datë 14.V.2001 dhe VKM nr. 327, datë 15.III.2003.

B. Të dënuarit me vendim të formës së prerë dhe respektimi i të drejtave të tyre

3. Nga vëzhgimet gjatë tremujorit të fundit të vitit 2003, në disa nga komisaritet u vu re se ishin marrë masa dhe një numër i konsiderueshëm të dënuarish me vendim të formës së prerë të gjykatës ishin transferuar. P.sh., në komisaritin e policisë të Korçës ishin transferuar 40 të dënuar, në komisaritin e policisë të Kukësit ishin transferuar rreth 13 të dënuar. Kjo ka ulur nivelin e mbipopullimit në këto komisarite. Megjithatë, mbajtja në mjediset e paraburgimit e personave të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës vazhdon të jetë shqetësuese. Siç u theksua edhe më lart, në dhomat e paraburgimit në komisaritet e policisë vazhdojnë të mbahen persona të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës. Kështu, në komisaritin e policisë të Fierit ka 17 të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës; në atë të Korçës, 13; të Elbasanit, 12; të Vlorës 5; të Kukësit, 5 dhe të Gjirokastrës, 1 të dënuar.⁴ Mbajtja e personave të dënuar në paraburgim cenon rëndë të drejtat e kësaj kategorie shtetasish si dhe përbën shkelje të ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale, sipas të cilit, menjëherë pas vendimit të gjykatës që ka marrë formë të prerë, i dënuari duhet të transferohet në institucionin e vuajtjes së dënimit.

⁴ Këto të dhëna i përkasin tremujorit të parë të vitit 2004, gjatë vëzhgimeve të korrespondentëve të KSHH-së.

Në bashkëbisedimet e korrespondentëve të KSHH-së me drejtues të komisariateve, u vu në pah se ata kanë bërë kërkesë me shkrim për transferimin e të dënuarve me vendim të formës së prerë, por ose nuk kanë marrë përgjigje nga organet kompetente, ose këto të fundit janë mjaftuar me justifikimin se nuk kanë mjedise në dispozicion për të bërë transferimin e personave me vendim të formës së prerë.

Duhet theksuar se KSHH-ja, edhe më parë, e ka trajtuar këtë çështje disa here. Vëmë në dukje se Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve, letrën⁵ dërguar nga KSHH-ja e trajtoi me seriozitet dhe mori masa të menjëhershme për të transferuar në vendet e vuajtjes së dënimit disa të dënuar me vendim të formës së prerë me probleme shëndetësore ose të dënuara femra që mbaheshin në dhomat e paraburgimit, të cilat nuk kishin kushtet minimale për trajtimin e kësaj kategorie të dënuarish.

C. Mbipopullimi, pasojat e tija dhe kushtet e tjera fizike në komisariatin e policisë

4. Edhe pas transferimeve të të dënuarve me vendim të formës së prerë të gjykatës, dukuria e mbipopullimit vazhdon të jetë e pranishme në të gjitha komisariatet e policisë ku u zhvillua vëzhgimi. Në disa prej tyre, si p.sh., në Shkodër, numri aktual i personave të mbajtur në këtë komisarjat është rreth trefish në krahasim me kapacitetin e lejuar të këtij institucioni⁶. Për pasojë, numri i personave të mbajtur në një qeli është rreth dyfish në krahasim me kapacitetin e lejuar të dhomave. Korrespondentët e KSHH-së kanë raportuar edhe raste kur në një qeli të këtij komisarjati janë mbajtur deri në 27 të paraburgosur, ndërkohë që kapaciteti i qelisë ka qenë për 10—12 persona. Faktet e mësipërme janë shprehje e qartë e cenimit të të drejtave që gëzojnë këta persona, për arsyen e thjeshtë se oraret e takimeve me familjarët, koha e ajrimit, e pastrimit etj., zvogëlohen në varësi të numrit të personave që mbahen në komisarjat.

Të paraburgosurit, sipas nenit 28 të ligjit nr. 8328, datë 16.IV1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, kanë të drejtën e ajrimit jo më pak se 2 orë në ditë. Kjo kohë, për shkaqe të jashtëzakonshme, me urdhër të drejtorit, mund të reduktohet deri në 1 orë. Gjatë vëzhgimeve është vënë re se kjo kohë nuk është respektuar, kryesisht si rrjedhojë e mbipopullimit në të gjitha komisarjatet e vëzhguara.

⁵ Në aneksin nr. 2, lutemi të lexoni letrën e KSHH-së drejtuar autoriteteve shtetërore në lidhje me rekomandimin e këtij të fundit për transferimin e disa të dënuarve me vendim të formës së prerë në vendet e vuajtjes së dënimit si edhe përgjigjen zyrtare të DPSH-së për transferimin e tyre.

⁶ Të dhënat i përkasin periudhës kur janë zhvilluar vëzhgimet, për këtë ju lutem lexoni në aneksin nr. 1, në këtë raport.

5. Gjithashtu, edhe vetë fakti që dhomat në komisariatet e vëzhguara ishin pothuajse të gjitha të mbipopulluara, cenon të drejtën e personave të mbajtur në komisariate për një jetë normale (neni 23 i ligjit nr. 8328, datë 16.IV.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, si edhe neni 24 i po këtij ligji, që thotë se mjediset e fjetjes duhet të kenë hapësira të mjaftueshme, të ajrosura, të pajisura me shërbime higjienike). Nga vëzhgimet e ndërmarra është konstatuar se në të gjitha komisariatet e vëzhguara kushtet e dhomave janë shumë të këqija: ka lagështirë, mungon ndriçimi, dhomat janë të paajrosura dhe në shumë raste me erë të keqe etj.

6. Për shkak të mbipopullimit dhe si rrjedhojë e numrit të paktë të qelive, nga njëra anë, dhe numrit të madh të të paraburgosurve dhe të dënuarve me vendim të formës së prerë që ndodhen në komisariate, nga ana tjetër, në disa komisariate të miturit mbahen në të njëjtat qeli me të rriturit. Rasti më i rëndë i raportuar është ai i konstatuar në komisariatit e Fierit ku mbahen 12 minorenë të cilët qëndrojnë në dhoma të përbashkëta me të rriturit dhe me persona të akuzuar për krime të rënda.

7. Nga vëzhgimet e kryera, korrespondentët e KSHH-së kanë raportuar, gjithashtu, se normativa e ushqimit për të paraburgosurit dhe të dënuarit është shumë e ulët. Për këtë arsye, ushqimet u vijnë nga të afërmit e tyre. Mjediset ku mbahet ushqimi, p.sh., në komisariatit e Korçës, janë gjithë myk dhe mikrobe. Në disa raste të tjera, si në Shkodër, ushqimet mbahen nëpër qese plastike, pasi nuk ka raftet e mjaftueshme për mbajtjen e tyre. Për krijimin e hapësirave frigoriferike ku të paraburgosurit të mund të mbajnë ushqimin e tyre në kushte të përshtatshme as nuk bëhet fjalë. Një situatë e tillë është në kundërshtim me nenin 27 të ligjit nr. 8328, datë 16.IV.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i cili thotë se të paraburgosurve dhe të dënuarve u sigurohet ushqim i shëndetshëm dhe i mjaftueshëm, i përshtatshëm për moshën, gjendjen shëndetësore, klimën dhe stinën.

8. Me gjithë ndonjë përmirësim, të vënë re në komisariatit e Gjirokastrës dhe atë të Fierit, shërbimi mjekësor në rrethet e tjera lë shumë për të dëshiruar. Problem shqetësues në të gjitha komisariatet mbetet pajisja e këtyre institucioneve me ilaçe, pasi, në shumicën e rasteve, mjeku ose ndihmësmjeku është i pajisur vetëm me paracetamolë dhe aspirina. Kështu edhe sigurimi i ilaçeve bëhet nga të afërmit e të paraburgosurve. Të paraburgosurve dhe të dënuarve që gjenden në dhomat e paraburgimit, duhet t’u sigurohet shërbimi mjekësor gjatë gjithë kohës, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 8328, datë 16.IV.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”. Ky shërbim shëndetësor, sipas nenit

30 të po këtij ligji, përfshin: diagnostikimin dhe mjekimin, furnizimin me ilaçe dhe pajisje mjekësore dhe profilaksi për sëmundjet.

9. Një tjetër problem shqetësues i theksuar në raportet e korrespondentëve të KSHH-së ka qenë mbajtja në komisariate dhe jo në institucionet e posaçme, të përcaktuara me ligj, e të paraburgosurve ose e të dënuarve me vendim të formës së prerë me probleme mendore ose fizike. P.sh., gjatë periudhës së vëzhgimit, në paraburgimin e rrethit të Vlorës gjendeshin 8 persona me probleme mendore dhe fizike; në komisariatit e Fierit gjendeshin 2 persona me shqetësime psikike si edhe të dënuar me vendim të formës së prerë të sëmurë me sëmundje kronike⁷. Janë raportuar edhe raste të tjera, si në Kukës dhe në Korçë, ku të paraburgosur me sëmundje të rënda kronike mbahen në mjediset e papërshtatshme të paraburgimit.

D. Kushtet sanitare

10. Nga vëzhgimi që u bë në të shtatë komisariatet rezultoi se garantimi i kushteve higjienike personale linte shumë për të dëshiruar. Mbipopullimi i theksuar e bënte thuajse të pamundur marrjen e masave konkrete për t'u siguruar të paraburgosurve kushte optimale për higjienën vetjake. Kjo situatë shqetësuese bie ndesh me nenin 26 të ligjit nr. 8328, datë 16.IV.1998, "Të dënuarit i sigurohen mjediset, pajisjet dhe mjetet e nevojshme për pastërtinë vetjake, në përpjesëtim me numrin e përdoruesve, që të garantojnë në mënyrë sa më optimale higjienën vetjake".

11. Infrastruktura e dusheve dhe e tualeteve, në të gjitha komisariatet e vëzhguara, është shumë e keqe. Çdo i paraburgosur ka të drejtën të bëjë dush një herë në dhjetë ditë, por kushtet e komisariateve, me një mbipopullim shqetësues, nuk lënë vend për përmirësim në këtë drejtim.

E. Drejta për takime me familjarët

12. Nga vëzhgimet e kryera rezulton se takimet me të afërmit kufizohen për shkak të mbipopullimit dhe mungesës së infrastrukturës së mjaftueshme të këtyre institucioneve. P.sh., në Shkodër, në përgjithësi,

⁷ Për njërin nga këto raste u morën masa të shpejta nga DPSH-ja pas ndërhyrjes dhe rekomandimit të KSHH-së për transferimin e këtyre personave të sëmurë në institucione të posaçme.

alternohen dy të paraburgosur të cilët takohen me të afërmit e tyre njëkohësisht, në të njëjtën dhomë.⁸

F. E drejta e informimit

13. Gjithashtu, të ndaluarve dhe të arrestuarve nuk u lejohen gazetat, librat, letra dhe mjete për të shkruar duke shkelur, kështu, nenin 75 të ligjit nr. 8328, datë 16.IV.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", ku theksohet: "Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj të arrestuarve dhe të ndaluarve, duke respektuar kufizimet e vendosura për ta me ligje të tjera".

G. E drejta për mbrojtje ligjore dhe njohja me të drejtat e tjera

14. Kushtetuta e RSH-së, në nenin 31/ç, sanksionon se, gjatë procesit penal, kushdo ka të drejtën të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të si edhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur personi nuk ka mjete financiare të mjaftueshme. Gjithashtu, Kodi i procedurës penale, neni 6 dhe 463/2, parashikon se i pandehuri/dënuari ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur personi nuk ka mjete të mjaftueshme, atij i sigurohet mbrojtja ligjore falas. Nga intervistat me të paraburgosur në komisarate, si në Gjirokastrë, Shkodër dhe Fier, rezultoi se takimet me avokatët kanë qenë të rregullta, ndërsa në Korçë, Elbasan e Vlorë disa prej të paraburgosurve nuk kanë pasur avokat dhe shumë herë kjo e drejtë u është mohuar. Nga intervistat me të ndaluarit u vunë në dukje raste të përzgjedhjes së avokatëve jo sipas listës, por sipas preferencave të policisë, që thirren në fund të një hetimi dhe firmosin proceverbale, pa lexuar përmbajtjen e tyre. Gjithashtu, të intervistuarit u ankuan për shërbimin avokator falas, shërbim i cili lë shumë për të dëshiruar për cilësinë.

15. Jo në të gjitha rastet të ndaluarit e të arrestuarit janë njohur me të drejtat që u garanton ligji që në çastin e ndalimit ose të arrestimit të tyre. Ata zakonisht janë njohur me të drejtat e tyre kur u është siguruar avokati mbrojtës.

H. Probleme të tjera

⁸ Kjo çon në shkelje të nenit 34 të ligjit nr. 8328, datë 16.IV.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim". Të paraburgosurit lejohen të kenë takime, sidomos me familjarët, duke marrë parasysh kushtet e institucionit.

16. Korrespondentët e KSHH-së, në raportet e tyre, kanë vënë në pah se ka pasur pretendime nga ana e të ndaluarve, të arrestuarve dhe të paraburgosurve për përdorim dhune nga ana e policisë gjatë momentit të ndalimit ose shoqërimit të tyre në komisariatet e policisë. Korrespondentja e Korçës ka raportuar se, gjatë intervistave me të ndaluarit, këta të fundit janë ankuar për kushtet e këqija dhe për trajtimin jo të mirë nga ana e administratës në komisariat.

17. Nga korrespondentët në Shkodër dhe në Vlorë janë raportuar raste të moskoordinimit midis gjykatave dhe administratës së komisariateve të policisë të cilët mbulojnë shoqërimin e të pandehurve në seancat gjyqësore. Kështu, ka ndodhur që disa gjyqtarë kanë caktuar zhvillimin e gjykimit në të njëjtën orë, gjë që ka çuar në vështirësi të mbulimit me efektiva shoqërues të policisë të të pandehurve në gjykatat e rretheve.

IV. Rekomandime

1. Në lidhje me transferimin e sistemit të paraburgimit, KSHH-ja u kërkon organeve kompetente të marrin masa konkrete për zbatimin dhe për respektimin e ligjit nr. 8678, datë 14.V.2001 dhe të VKM-së nr. 327, datë 15.V.2003.
2. Të merren të gjitha masat për transferimin e të dënuarve me vendim të formës së prerë të gjykatës në vendet përkatëse të vuajtjes së dënimit ose të konvertohet koha e qëndrimit në paraburgim e kësaj kategorie individësh në favor të tyre, siç e parashikon ligji.
3. Të bëhen përpjekje për të përmirësuar infrastrukturën e ndërtesave të komisariateve të policisë me qëllim përmirësimin e kushteve fizike në dhomat e paraburgimit, gjë që do të çojë në një respektim më të mirë të të drejtave të paraburgosurve.
4. Organet përkatëse të tregohen më të kujdesshme në klasifikimin e të paraburgosurve dhe në ndarjen e tyre në dhomat e paraburgimit.
5. Kujdes duhet treguar në mbajtjen e të miturve veças nga të rriturit.
6. Të krijohen mjedise frigoriferike për të ruajtur ushqimin e të paraburgosurve dhe këta të fundit nuk duhet të mbajnë ushqime në qeli.
7. Duhet të merren masat e nevojshme për të siguruar kushte të përshtatshme higjieno-sanitare për t'u garantuar kështu të paraburgosurve mundësi për një higjienë personale të përshtatshme.
8. Të merren masa efikase për t'u siguruar të paraburgosurve një shërbim mjekësor në përputhje me ligjin. Të merren masa për të siguruar një furnizim të mjaftueshëm me ilaçe në paraburgim.
9. Të sëmuret me probleme mendore ose psikike, ose të sëmuret me sëmundje kronike të transferohen në institucione të posaçme, të përcaktuara me ligj.
10. Të paraburgosurve duhet t'u sigurohet aksesimi tek gazetatat, librat etj. Theksojmë edhe një herë se, në qoftë se do të ishte e nevojshme të merreshin masa të tjera ndaj të ndaluarve dhe të paraburgosurve,

veç atyre që parashikohen në ligjin nr. 8328, dt. 16.IV.1998, ato mund të vendoseshin vetëm me ligje të tjera (pra jo me rregullore apo me akte nënligjore). KSHH-ja sugjeron që të sigurohet zbatimi i përpiktë i nenit 75 të ligjit nr. 8328 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim".

11. Të paraburgosurit duhet të informohen për të drejtat e tyre si edhe për të drejtën për mbrojtje ligjore qysh në çastin e ndalimit dhe të arrestimit edhe në rastet kur këta të fundit nuk kanë mjetet e mjaftueshme financiare.
12. Të merren masa nga organet e Policisë së Shtetit dhe gjykatat e rretheve për një koordinim më të mirë midis tyre për të shmangur zvarritjet e seancave gjyqësore.

Aneks nr. 1

I Komisaritet e vëzhguara dhe periudha e vëzhgimit (sipas rendit alfabetik)

1. Komisariati i Elbasanit	14, 21, 27, 28 shkurt 2004
2. Komisariati i Fierit	22 mars 2004
3. Komisariati i Gjirokastrës	6, 10, 25, 27 shkurt 2004; 3 mars 2004
4. Komisariati i Korçës	15 – 18 shkurt 2004
5. Komisariati i Kukësit	në fund të janarit dhe gjatë muajit shkurt
6. Komisariati i Shkodrës	30 janar 2004; 20 shkurt 2004
7. Komisariati i Vlorës	1 – 10 shkurt 2004; 20 – 29 shkurt 2004

II Personat e intervistuar gjatë vëzhgimit

1. Në komisaritin e Elbasanit janë takuar dhe janë intervistuar:

a- Administrata e komisaritetit të rrethit të Elbasanit

- Shef i komisaritetit të Elbasanit
- Përgjegjësi i dhomave të paraburgimit
- Punonjës të tjerë të administratës

b- Të ndaluar, të arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar

- Janë takuar dhe janë intervistuar 22 persona

c- Të tjerë

- Drejtues të tjerë të policisë së qarkut

2. Në komisaritin e Fierit janë takuar dhe janë intervistuar:

a- Administrata e komisaritetit të rrethit të Fierit

- Shefi i komisaritetit
- Shefi i zyrës së krimeve
- Përgjegjësi i dhomave të paraburgimit
- Punonjës të tjerë të administratës

b- Të ndaluar, të arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar

- Janë takuar disa persona
- Janë intervistuar 2 persona

3. Në komisaritin e Gjirokastrës janë takuar dhe janë intervistuar:

a- Administrata e komisaritetit të rrethit të Gjirokastrës

- Punonjës të komisaritetit
- Mjeku i komisaritetit
- Punonjës të tjerë të administratës

b- Prokurorë dhe gjyqtarë të ndryshëm

- 2 prokurorë

c- Të ndaluar, të arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar

- Janë intervistuar 9 persona

4. Në komisariatit e Korçës janë takuar dhe janë intervistuar:

a- Administrata e komisariatit të rrethit të Korçës

- Shefi i komisariatit
- Shefi i rendit (i komanduar)
- Komandanti i repartit në dhomat e paraburgimit
- Mjeku i komisariatit
- Punonjës të tjerë të administratës

b- Avokatë të të ndaluarve

- 3 avokatë

c- Të ndaluar, të arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar

- Janë takuar 40 persona
- Janë intervistuar 20

d- Të tjerë

- Të afërm të të dënuarve

5. Në komisariatit e Kukësit janë takuar dhe janë intervistuar:

a- Administrata e komisariatit të rrethit të Kukësit

- Shefi i komisariatit
- Nëndrejtori i policisë
- Shefi i rendit
- Shefi i krimeve
- Shefja e sektorit të propagandës dhe sekretarisë
- Personeli në zyrën e informacionit
- Rojet e brendshme të dhomave të paraburgimit
- Përgjegjësit e dhomave të paraburgimit
- Kryetari i komisionit disiplinor
- Komandanti i repartit
- Punonjës të tjerë të administratës

d- Të ndaluar, të arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar

- Janë takuar dhe janë intervistuar 40 persona

6. Në komisariatit e Shkodrës janë takuar dhe janë intervistuar:

a- Administrata e komisariatit të rrethit të Shkodrës

- Përgjegjësit e dhomave të paraburgimit

- Punonjës të tjerë të administratës

b- Të ndaluar, të arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar

- Janë intervistuar 14 persona

c- Të tjerë

- Shefi i zyrës së rendit në Drejtorinë e Policisë së Qarkut

7. Në komisariatit e Vlorës janë takuar dhe janë intervistuar:

a- Administrata e komisariatit të rrethit të Vlorës

- Shefi i komisariatit
- Mjeku i komisariatit
- Punonjësit e tjerë të administratës

b- Prokurorë dhe gjyqtarë të ndryshëm

- Zëvendësprokurori i rrethit
- Prokurorë të tjerë

c- Avokatë të të ndaluarve/paraburgosurve


- 5 avokatë

d- Të ndaluar, të arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar

- Janë takuar dhe janë intervistuar 96 persona

Aneks nr. 2

Korrespondenca mes KSHH-së dhe institucioneve shtetërore në këtë fushë


KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Member of International Helsinki Federation for Human Rights

Nr. Prot. 105 Tiranë, 29.03.2003

Për: z. Ramadan Hasanaj,
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

Për dijeni: z. Bajram Ibraj
Drejtori i Përgjithshëm i policisë së shtetit

z. Igli Toska
Ministër i Rendit Publik

z. Theodhori Sallaku
Prokuror i Përgjithshëm

Nga: znj. Vasilika Hysi
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
Tiranë

I nderuar z. Hasanaj,

Gjatë muajit Mars 2004, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, nëpërmjet korrespondentit të tij në rrethin e Fierit ka kryer vëzhgime në Komisariatin e Policisë së këtij rrethi dhe më konkretisht në dhomat e paraburgimit. KSHH do të dalë me një raport më të plotë në lidhje me situatën në këtë komisarjat por me anë të kësaj shkresë do t'ju njohë me disa shqetësime serioze të konstatuara gjatë vëzhgimit në këtë Komisarjat të cilat po i paraqesim si më poshtë:

- Skënder Muço, nga Patosi, i dënuar me 5 vjet, me vendim të formës së prerë për mashtrim është 74 vjeç i sëmurë nga zemra dhe tensioni dhe e ka të pa përballueshme qëndrimin në dhomat e paraburgimit me kushte të vështira.
- Feruze Bregu, e dënuar me vendim të formës së prerë 20 vjet për vrasje, është e vetmja femër në qelitë e paraburgimit dhe s'ka kushte për të qëndruar në atë ambient.



- I ndaluari Pellumb Goxhaj paraqet probleme mendore prej 3 muajsh, nuk flet, zhvishet lakuriq, del jashtë në qeli (defekon). Gjendja shëndetësore vjen duke u rënduar dhe dobësuar së tepërmi. Me vendim të gjykatës dhe prokurorisë është çuar në Spitalin e Burgjeve në Tiranë dhe nuk është mbajtur. Akuzohet për krimin e vrasjes.

KSHH, ju drejtohet juve që të bëni përpjekje për transferimin sa më parë të personave të mësipërm të dënuar me vendim të formës së prerë që aktualisht ndodhen në ambientet e komisarjatis të rrethit të Fierit.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin e deri tanishëm.

Me respekt,

Vasilika Hysi
Drejtoresh Ekzekutive

Aneks nr. 3

KORRESPONDENTËT E KSHH-SË NË RRETHE